



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA SHËRBIMEVE SOCIALE,
STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Nr. 797 Prot
Shkodër, më 18.01.2019



FONDACIONI
"HOPE FOR THE WORLD"

Nr. 12 Prot
Tiranë, më 17.01.2019

MARRËVESHJE

BASHKËPUNIMI

E lidhur sot në Bashkinë Shkodër, me datë 18/01/2019, ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

Fondacionit "Hope for the World" përfaqësuar nga drejtor z. Përparim Demçellari

dhe

Bashkisë Shkodër përfaqësuar nga kryetar zj.Voltana Ademi.

Baza ligjore

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi lidhet në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", Ligji nr. 7850 datë 29.07.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurese" i ndryshuar, Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr. 658 datë 17.10.2005 "Për standartet e shërbimeve shoqërore", ligjin nr. 18/2017 "Për të drejtat e mbrojtjes së fëmijës", Vendimit nr. 89, datë 26. 01. 2012 " Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe të procedurës së shërbimit të kujdestarisë", udhëzimit nr. 11, datë 09. 03. 2015 " Mbi zbatimin e VKM-së nr. 89" dhe Udhëzimit nr. 10, datë 25.02.2015 "Për mënyrat, format, e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për



mbrojtjen e fëmijës”.

OBJEKTI i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi për përkujdesjen, mirëritjen dhe edukimin e fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës Shkollor, Shtëpisë së Foshnjës dhe Qendrës së Zhvillimit Shkodër.

KOHËZGJATJA e kësaj marrëveshje bashkëpunimi do të jetë nga data e nënshkrimit deri më 31.12.2019.

KUSHTET e marrëveshjes së bashkëpunimit:

1. Fondacioni “Hope for the World” merr përsipër:

Nëpërmjet Përfaqësuesit Vendor të tij, në bashkëpunim me Drejtoritë e institucioneve të sipërpërmendura:

- Projektin: **“Të gëzojmë dhe festojmë së bashku”**
- Të organizojë dhe të mbështesë financiarisht ditëlindjen e secilit fëmijë/klient të këtyre qendrave, për kremtimin sa më të mirë të ditëlindjeve të fëmijëve dhe për bërjen e dhuratave të ndryshme për ta, në Shtëpine e Foshnjës me \$760, në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor \$ 1200 dhe Qendrën e Zhvillimit \$2000.
- Të organizojë dhe të mbështesë financiarisht kremtimin e festave ndërvjetore, në Shtëpine e Foshnjës \$550, në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor \$1640 dhe Qendrën e Zhvillimit \$700.
- Projektin **“Përfshirje në aktivitete kulturore-sportive”**. Të nxisë dhe të mbështesë talentet e reja në pikturë, muzikë, sport etj. në Shtëpine e Foshnjës me \$200, në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor \$ 1560 dhe Qendrën e Zhvillimit \$380.
- Projektin **“Të shijojmë natyrën”**. Të organizojë dhe të mbështesë financiarisht kryerjen e aktiviteteve të ndryshme me fëmijët në Shtëpine e Foshnjës me \$570, në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor \$1000.
- Të mbështesë për **“Pushimet Verore”**, në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor \$600.
- Projektin **“Jemi afër”**. Të mbështesë, transportin (çmim bilete) për takimet e familjarëve me fëmijët e tyre të cilët jetojnë në Shtëpinë e Foshnjës \$120
- Të mbështesë për **“Nevojat Higjeno-Sanitare”** në Qendrën e Zhvillimit \$720.
- Të organizojë dhe të mbështesë financiarisht kremtimin e festave të Krishtlindjes dhe të Vitit të Ri si dhe bërjen e dhuratave të ndryshme në Shtëpine e Foshnjës \$600, në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor \$1380 dhe Qendrën e Zhvillimit \$2460.
- Kontributi financiar për mbështetjen e aktiviteteve të sipërpërmendura do të jetë i ndryshueshëm në çdo muaj në varësi të numrit të fëmijëve në institucion.



- Shpenzimet e përgjithshme vjetore që do të mbështesë fondacioni për Shtëpitë e Fëmijës dhe qendrën e Zhvillimit do të jenë 16440 \$, te ndara sipas institucioneve: Shtëpia e Foshnjës \$ 2800 ,Sh.F.Shkollor \$ 7380 dhe Qendra e Zhvillimit \$ 6260.
- Fondacioni mirëpret brenda muajit Maj 2019 projekte me vlerë deri në 3000\$, për tu përfshirë në Marrëveshjen e Bashkëpunimit për vitin 2020.
- Fondacioni paraqet raport narrativ dhe financiar 6 mujor, mbi ndërhyrjet, mbështetjen dhe aktivitetet e zhvilluara në shtëpinë e fëmijës shkollor pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, Strehimit dhe Shëndetit Publik, në Bashkinë Shkodër dhe gjithashtu pranë Zyrës Qendrore të Fondacionit "Hope for the World".

2. Drejtoritë e Shtëpive të Fëmijëve dhe Qendra e Zhvillimit marrin përsipër:

- Të jenë disponibël me përfaqësuesit e Fondacionit për t'u ofruar të dhënat personale të fëmijëve që kanë të bëjnë me lindjen, prejardhjen, edukimin, karakterin, prirjet etj., për të mundësuar veprimin sa më funksional të aktivitetit të Fondacionit.
- Të lejojnë vizita miqësore të individëve apo grupeve të ndryshme misionarësh të huaj, të organizuara nga fondacioni, të cilët edhe mund të kontribuojnë në ndihmë të institucionit.
- Të lejojnë vendosjen e mjeteve promociionale (postera, foto, etj.) të Fondacionit në ambientet e Shtëpive të Fëmijëve dhe Qendrës së Zhvillimit
- Të vënë në dispozicion nga një dhomë që do të shërbejë për aktivitete edukativo-kulturore që do të kryhen nga punonjësi i Fondacionit dhe do shëbejë gjithashtu si ambient zyre për të, pa shpërblim.
- Për aktivitetet, kremtimin e ditëlindjeve, blerjen e dhuratave dhe detyra të ngjashme me to, të jenë të pranishëm edhe edukatorë apo përfaqësues të institucioneve respektive.

Të paraqesin faturat e shpenzimeve të aktiviteteve që mbulohen financiarisht nga fondacioni pranë përfaqësuesit të fondacionit.

- Për mirëmbajtjen e ambienteve të institucioneve, më parë duhet të konfirmohet projekti dhe preventivi nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit pranë Bashkisë së Shkodrës dhe Drejtoria e Shërbimit Social, Strehimit dhe Shëndetit Publik dhe gjithashtu nga fondacioni.
- Zbatimin e ligjeve dhe rregullave për administrimin e kontributit material e financiar të Fondacionit.



NIVELI I SHËRBIMEVE

Këto shërbime do të kryhen në përputhje me standartet, kushtet dhe normativat e legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Marrëveshja e Bashkëpunimit DETYRON:

- Drejtoritë e Institucioneve dhe Fondacionin që të informojë në organet përkatëse të Bashkisë së Shkodrës, mbi ecurinë e zbatimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
- Drejtorinë e Shërbimit Social, Strehimit dhe Shëndetit Publik të monitorojë mbarëvajtjen e aktiviteteve dhe shërbimeve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi.

KUSHTET për NDRYSHIME dhe ZGJIDHJE të marrëveshjes:

- Për pika të veçanta, marrëveshja mund të pësojë ndryshime gjatë vitit, me kërkesë dhe miratim nga të dyja palët.
- Kjo marrëveshje, pasi u lexua nga palët, u nënshkrua me vullnetin e tyre të plotë.
- Kjo marrëveshje u përpilua dhe u nënshkrua në pesë kopje.

PËR
BASHKINË SHKODËR

KRYETAR



PËR
FONDACIONIN "HOPE FOR THE
WORLD"

DREJTOR

